



GGD

GRUPI I GRAVE DEPUTETE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly





Grupi i Grave Deputete (GGD) është themeluar në korrik të vitit 2005 dhe përbëhet nga të gjitha deputetet e të gjitha partive politike të të gjitha nacionaliteteve të përfaqësuara në Kuvend.

GGD, në këtë mandat, ka 40 anëtare, derisa Bordi i GGD-së udhëhiqet nga kryetarja e zgjedhur me votimin e fshehtë të anëtareve.

Përbërja e Bordit të GGD-së:

- | | |
|---------------------------|------------------------|
| Teuta Sahatqija (LDK) | - Kryetare |
| Flora Brovina (PDK) | - Anëtare |
| Donika Kadaj-Bujupi (AAK) | - Anëtare |
| Alma Lama (VV) | - Anëtare |
| Suzana Novobërdaliu (KKR) | - Anëtare |
| Jelena Bontic (SLS) | - Anëtare |
| Myfera Sinik (6+) | - Anëtare |
| Sebahate Grajçevci | - Këshilltare e GGD-së |
| Arjeta Rexhepi | - Asistente e GGD-së |

GGD vepron në bazë të Strategjisë së Veprimit dhe Planit Vjetor të Veprimit.

MISIONI I GGD-së është promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i gruas në të gjithë sektorët e jetës.

OBJEKTIVI KRYESOR është përmbushja e Objektivit të tretë të Objektivave të Zhvillimit të Mileniumit (OZHM), dhe objektivave 39, 40, dhe 116 të Planit të Veprimit për Partneritet Evropian-PVPE.

Objektivi i përgjithshëm i GGD-së:

Respektimi i të drejtave njerëzore të grave dhe sigurimi i pjesëmarrjes së barabartë të gruas në të gjitha sferat e shoqërisë dhe në vendim-marrje, drejt ndërtimit të shtetit demokratik të Kosovës.

Objektivat specifike:

- ✎ Harmonizimi, amandamentimi dhe hartimi i legjislacionit shikuar nga perspektiva gjinore.
- ✎ Përmirësimi i pozitës së grave në partitë politike dhe në politikë në përgjithësi.
- ✎ Përmirësimi i pozitës së grave në shoqërinë kosovare.
- ✎ Shtimi i bashkëpunimit të GGD-së me gratë në shoqërinë kosovare dhe deputete nga vende tjera.

Aktivitetet në Parlament:

- ✎ Seancë e veçantë parlamentare më temën: "Pozita e gruas në shoqërinë kosovare - qasja në drejtësi dhe fuqizimi ekonomik";
- ✎ Propozim-amandamente, në favor të përfshirjes së gruas në: "Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës";
- ✎ Ligjet e trajtuara nga perspektiva gjinore;
- ✎ Pjesëmarrja e përfaqësuesve të GGD-së në grupe punuese: siç janë: Grupi për Hartimin e Kushtetutës së Kosovës dhe Grupi për Reformën Zgjedhore;
- ✎ Reagimi për listën një gjinore të propozimeve për ambasadorë që rezultoi me emërimet edhe të grave në këto poste;
- ✎ Përfshirja e përfaqësuesve të GGD-së në delegacionet e Kryesisë së Kuvendit, si në takimet e organizuara në Kuvend ashtu edhe në vizitat jashtë vendit;
- ✎ Në seanca parlamentare, si: "Qasja e gruas në drejtësi dhe fuqizimi ekonomik".



TRYEZAT E ORGANIZUARA

- ✘ **Në bashkëpunim me NDI janë mbajtur tryezat me temën:** “Reforma zgjedhore”; “Dhuna në familje”; “Pse gratë kanë nevojë për gratë”; “Kanceri në gji dhe qafë të mitrës”; dhe “Mediat dhe portretizimi i gruas në media”.
- ✘ **Me UNDP-në:** “Gruaja dhe qasja e saj në drejtësi”.
- ✘ **Me Odën Ekonomike të Koblenct të Gjermanisë:** “Zejtaria, mundësi punësimi për gratë”.
- ✘ **Me Universitetin e Prishtinës:** “Përfaqësimi i gruas në UP, në vendim-marrje dhe në strukturat udhëheqëse të Universitetit”.



AKTIVITETET NËPËR KOMUNA:

- ✘ **Në bashkëpunim me USAID-DEMI është organizuar tryeza “Roli i Gruas në Qeverisjen Lokale”,** në komunat: Kamenicë, Kaçanik, Gjilan, Malishevë, Mitrovicë, Vushtrri dhe Fushë Kosovë; Gjilan, Shtërpçë, Ranillug, Graçanicë, Partesh, Novobërdë, Kllokot; Pejë, Gjakovë, Deçan, Istog, Suharekë dhe Mamushë.
- ✘ **Në bashkëpunim me Friedrih Ebert Stiftung dhe Top Radio, tryeza: “Reforma Zgjedhore dhe Fuqizimi i Gruas”** në komunat: Gjakovë, Pejë, Istog, Gjilan, Prizren, Klinë, Suharekë, Vushtrri, Deçan, dhe Ferizaj.
- ✘ **Në bashkëpunim me OSBE takime me gratë e komunave të rajonit të Prishtinës:** Prishtinës, Graçanicës, Obiliqit, Fushë Kosovës, Lipjanit, Shtimes, Ferizajit dhe Podujevës.

BASHKËPUNIMI RAJONAL

GGD është e përkushtuar në avancimin e bashkëpunimit rajonal me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe thellimit të partneritetit.

- ✎ Pjesëmarrje në konferenca të organizuara në Shqipëri;
- ✎ Konferenca me karakter regjional me ABGJ me temën “Roli i gruas në proceset integruese”;
- ✎ Deputetet dhe aktiviste nga Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i Zi ftohen që të marrin pjesë në aktivitetet e organizuara nga GGD.

VIZITAT JASHTË VENDIT:

- ✎ Përkrahur nga UNDP, pjesëmarrje dhe përfaqësim në konferencën e mbajtur në Turqi;
- ✎ Përkrahur nga OSBE vizitë në Suedi;
- ✎ Përkrahur nga UNDP vizitë në Austri;
- ✎ Vizitë në SHBA.

TAKIME:

Me synimin që të bashkërendojë aktivitetet e planifikuara GGD organizon takime të rregullta pune me organizata e personalitete të fushave të ndryshme, shoqërinë civile dhe mediat që veprojnë në Kosovë.



AKTIVITETI DIPLOMATIK

Takimet me delegacione të vendeve të ndryshme të botës janë pjesë e agjendës së aktiviteteve të GGD-së.

GGD është zë i fuqishëm i përfaqësimit të gruas në Kosovë.

Vlen të përmenden takimet si ato me: Raportuesen për Kosovën në BE, znj. Ulrike Lunacek; Deputeten e Parlamentit Evropian, znj. Doris Pack; Guvernatorin Howard Dean, anëtar i Bordit të NDI; Delegacionin nga Bundestagu Gjerman; Shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë, z. Samuel Zhbogar; Ekspertë nga SHBA-ja; Delegacionin e Deputetëve të Parlamentit të Suedisë, në përberje ishte edhe deputeti suedez me prejardhje nga Kosova z. Adnan Dibrani; Delegacionin 20 anëtarësh nga pesë vendet e BE-së të cilat ende nuk e kanë njohur Kosovën; Kongresistë amerikanë; Ambasadorë të akredituar në Kosovë etj.

Bashkimi bën fuqi!



AKTIVITETE TJERA:

- ✘ Fushata kundër kancerit të gjirit;
- ✘ Aktivitete për blerjen e mamografit mobil;
- ✘ Vizita dhe takime me qytetarë;
- ✘ Debate televizive; etj.



- ✘ Në përckrahje nga UNDP, në Hollin e Kuvendit, është organizuar ekspozitë e piktoreve të Kosovës me temën “Gruaja dhe Arti”.
- ✘ Në përckrahje nga NDI është organizuar kursi i gjuhës angleze për deputete.
- ✘ Në përckrahje nga Ambasada e Francës është organizuar kursi i gjuhës frenge për deputete.

Bashkimi bën fuqi!



- GGD ka organizuar aktivitetin “Java e Gruas” në përkrahje nga NDI dhe USAID;
Ky aktivitet njëjavor synon avancimin e pozitës së gruas në shoqëri. Shumë gra, nga subjekte të ndryshme dhe nga komunitat, janë testuar për t’u kualifikuar që të jenë pjesë e punëtorive të organizuara dhe 100 prej tyre janë certifikuar.
- Ndarja e 11 mirënjohjeve nga GGD për personalitetet të cilat kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në: zhvillimin e demokracisë, lirinë e Kosovës, angazhimin për të drejtat e njeriut, promovimin e barazisë gjinore, kontribut në kulturë etj.
- Konferenca e QKSGJ në Bibliotekën Kombëtare me temën “Kuota Gjinore - përfaqësimi i barabartë për gratë në Kosovë”.
- Takim me fëmijët jetim në SOS fshatin e Fëmijëve.

PUBLIKIME:

- Përkrahur nga NDI, GGD publikon raportet vjetore;
- Në përkrahje nga UNDP, GGD përgatit dhe publikon buletinin mujor;
- Në përkrahje nga UNDP, GGD ka përgatitur dhe publikuar materialin promovues;
- Aktivitetet publikohen në faqen elektronike të Kuvendit;
- GGD është aktive edhe në mediat sociale si në Facebook, rrjetin “iKNOW politics” etj.

Bashkimi bën fuqi!



GRUPI I GRAVE DEPUTETE
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
Ndërtesa e Kuvendit, Kati III Nr. 319/A
E-mail: woman.caucus@assembly-kosova.org
Tel: 038 211 330



Ky material informues është pjesë e përkrahjes së ofruar përmes projektit për Zhvillim Parlamentar në Politika Sociale (PDSP). Ky projekt është i financuar nga DGTTF dhe implementohet nga UNDP.